



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Drzavna Agencija za Zastitu Licnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr.04/10
Datë:12.10.2012

Në mbështetje të nenit 68 të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 7 (paragrafi 9) i Rregullores së Punës Nr.20/2011 të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur më 12.10.2012,mori:

V E N D I M

1. Miratohet dhënia e autorizimit për përdorimin e karakteristikave biometrike për kontrollin e qasje në dhomën e Serverëve në TEB-Bankë Sh.A.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Më datë 03/10/2012 kontrollori TEB-Bankë ka bërë kërkesë për marrjen e autorizimit nga ana e Agjencisë, për përdorimin e pajisjes për kontrollin e qasjes në dhomën e Serverëve, pajisje e cila përdorë të dhëna biometrike respektivisht gjurmët e gishtërinjve.

Bazuar në nenin 68 paragrafi 1 dhe 2 kontrollori në kërkesë ka dhënë arsyetimin se instalimi i këtyre pajisjeve bëhet me qëllim të rritjes së sigurisë së kontrollit të qasjes në hapësirat ku janë të vendosura pajisjet kryesore kompjuterike të Bankës TEB.

Po ashtu Banka TEB ka ofruar një dokument në të cilin janë të përshkruar masat që janë ndërmarr me qëllim të mbrojtjes së të dhënave personale.

Njëkohësisht jemi njoftuar se Banka ka njoftuar me shkrim nëpunësit të cilët do të kenë qasje në hapësirat e lartcekura.

Më datën 12/10/2012 është bërë një kontroll në Bankën TEB me qëllim të verifikimit të nëse vendi ku parashihet të vendoset pajisja është në harmoni me Ligjin.


Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë.
- TEB Sh.A
- Arkivit të Agjencisë

Ruzhdi JASHARI


Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror